




Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU  
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 23 mars 2023

Kodi i ZRRE-së: V\_1704\_2023

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15 dhe Nenit 26 paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084;
- Dispozitat e Nenit 8, paragrafët 1 dhe 6, të Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081;
- Dispozitat e nenit 15 dhe nenit 26 paragrafi 1, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084;
- Dispozitat e Rregullës dhe Metodologjinë për Përgatitjen e Bilanceve të Energjisë Nr. 03/2020 (e nxjerrë në qershor 2020); dhe
- Kërkesën e bërë me datë 09 dhjetor 2022 nga përfaqësues të ndërmarrjes publike “**NGROHTORJA E QYTETIT SH.A**”, me adresë Rruga Tirana p.n., Gjakovë, Republika e Kosovës, për miratimin e dokumentit “Bilanci Vjetor i Energjisë Termike për vitin 2023”.

në seancën e mbajtur më 23 mars 2023 nxori këtë:

## V E N D I M

- I. **APROVOHET “Bilanci vjetor i energjisë termike për vitin 2023”** i ndërmarrjes “**NGROHTORJA E QYTETIT SH.A**”.
- II. **Obligohet** i licencuari që pas pranimit të këtij Vendimi ta publikojë dokumentin “Bilanci Vjetor i Energjisë Termike - 2023” në faqen elektronike zyrtare të tij.

## A R S Y E T I M

1. Ndërmarrja “**NGROHTORJA E QYTETIT SH.A**”. (në vijim N.Q.) si bartëse e Licencës për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë termike, bazuar në dispozitat ligjore të legjislacionit në fuqi ka përgatitur dokumentin “Bilanci Vjetor i Energjisë Termike për vitin 2023”. Në përputhje me procedurat ligjore dhe rregullative, drafti parë i këtij dokumenti është dorëzuar me 09 dhjetor 2022 për shqyrtim në ZRRE dhe në Ministrinë e Ekonomisë. Pas shqyrtimit dhe komentimit të këtij drafti nga këto dy institucione, me 08 shkurt 2023 është dorëzuar drafti i përmirësuar sipas komenteve. Ky draft final është vendosur në konsultim publik prej 14 – 28 shkurt 2023, me ç’rast nuk është pranuar asnjë koment – vërejtje ose sugjerim; rrjedhimisht, ky draft Bilanc është konsideruar i finalizuar për tu paraqitur para Bordit të ZRRE-së për miratim.



2. Pas shqyrtimit të draft-dokumentit “Bilanci Vjetor i Energjisë Termike - 2023” të dorëzuar nga NP Ngrohtorja e Qytetit Gjakovë sh.a. dhe përmirësimit e plotësimit të tij sipas komenteve të ME-së dhe ZRRE-së, Bordi i ZRRE-së duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
  3. Duke pasur parasysh ndikimin e parametrave të ndryshëm të bilancit në përcaktimin e tarifave, Rregullatori mban të drejtën që gjatë shqyrtimit tariforë të përshtatë të dhënat që përmban Bilanci vjetor i energjisë termike.
  4. Bazuar në dispozitat e Nenit 42 paragrafit 2.3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Rregullatori monitoron implementimin e Bilancit Vjetor të Energjisë Termike për të verifikuar realizimin e të dhënave dhe informatave të paraqitura në këtë Bilanc dhe mund të ndër marr veprime specifike për promovimin dhe përmirësimin e sigurisë afatshkurtër dhe afatgjatë të furnizimit me energji.
- III. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodhë e fundit.


Bashkëngjitur:


“Bilanci Vjetor i Energjisë Termike – 2023”


Vendimi ju dërgohet:


- Ndërmarrjes “**NGROHTORJA E QYTETIT SH.A**” dhe
- Arkivit të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së:

  
Ymer Fejzullahu, Kryesues

  
Lutfije Dervishi, Anëtare

  
Gani Buçaj, Anëtar



**NGROHTORJA E QYTETIT SH.A. GJAKOVË**  
**DICTRICT HEATING J.S.C. GJAKOVA**

Adresa: "Behije Dashi" Rezinë, Gjakovë  
Tel & Fax: (0390) 326 657  
Mob: +383 (0) 46 127 066

NUI: 811326471  
info@ngrohtorja.org  
www.ngrohtorja.org

---

**BILANCI VJETOR I ENERGJISË TERMIKE**  
**Për vitin 2023**

Gjakovë, mars 2023

# PËRMBAJTJA

<b>HYRJE.....</b>	<b>2</b>
<b>AKTIVITETI.....</b>	<b>2</b>
<b>SISTEMI I ENERGJISË TERMIKE.....</b>	<b>3</b>
<b>PËRSHKRIMI I KAPACITETEVE PËR PRODHIMIN E ENERGJISË TERMIKE.....</b>	<b>3</b>
<b>PËRSHKRIMI I RRJETIT TË SHPËRNDARJES.....</b>	<b>4</b>
<b>VIZIONI PËR ZHVILLIMIN E SISTEMIT TË ENERGJISË TERMIKE.....</b>	<b>6</b>
<b>PARASHIKIMI I KËRKESËS PËR ENERGJI TERMIKE.....</b>	<b>7</b>

## **HYRJE**

Bilanci vjetor për 2023 i Energjisë Termike për N.P. Ngrohtorja e Qytetit SH.A. Gjakovë, është përgatitur duke u bazuar në Ligjin Nr. 05/L-081 për Energjinë (neni 8) dhe Rregullën dhe Metodologjinë për Hartimin e Bilanceve të Energjisë të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE-së).

Ky dokument paraqet planifikimin njëvjeçar (sezonal) të kërkesës për energji termike dhe parashikimet për gjenerimin e nevojshëm të energjisë termike për të plotësuar këtë kërkesë, si dhe parashikimet për humbjet në prodhim dhe në rrjetin e shpërndarjes.

Parashikimi i të dhënave në këtë bilanc është bazuar në të dhënat historike, planet zhvillimore aktuale, dhe në studimet dhe strategjitë përkatëse sektoriale. Sidomos parashikimet janë të bazuara në Studimet dhe dokumentet e projektit për Ngrohtoren e Re dhe njësinë e ko - gjenerimit të NQ Gjakova.

Duke pasur parasysh se realizimi i punëve ndërtimore dhe instaluese është përfunduar sipas projeksioneve të parapara bashkë me të dhënat përkatëse mund të pësojnë vetëm disa ndryshime të vogla, për këtë të dhënat e paraqitura mund të konsiderohen se kanë saktësi dhe besueshmëri të lartë.

## **AKTIVITETI**

Duke pasur parasysh gjendjen në N.P. Ngrohtorja e Qytetit SH.A. në Gjakovë, ofrimi i ngrohjes gjatë sezonit dimëror vit pas viti është mundësuar duke ju falënderuar subvencioneve të ndara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e Ekonomisë.

Sezoni 2022/2023 për Ngrohtoren e Qytetit është sezoni i dytë i funksionimit të Impiantit të Ri me Biomassë. Ky Impiant është finalizuar dhe është lëshuar në punë, përkatësisht është vitin e dytë të operimit. Impianti është përfunduar zyrtarisht në Korrik 2021. Realizimi i këtij projekti do mundësoj që në të ardhmen të ofrohet furnizim i pandërprerë dhe kualitativ.

Në këtë drejtim, N.P. Ngrohtorja e Qytetit SH.A. në Gjakovë përpiqet t'i harmonizojë veprimet dhe aktivitetet e veta, gjithnjë me qëllim të vazhimit të operimit dhe ofrimit të ngrohjes cilësore për konsumatorët aktualë të paktën për pjesën jugore dhe atë veriore që është sanuar plotësisht gjatë këtij viti që po mbaron, gjegjësisht sipas projektit "Përmirësimi i performancës së Ngrohtores së Qytetit në Gjakovë" – financuar nga SECO Zvicrane dhe KK Gjakovë – komponenti 2. Përmirësimi i efijencën së energjisë në rrjetin e NQ.

## **SISTEMI I ENERGJISË TERMIKE**

### **Historiku**

Ndërmarrja publike "Ngrohtorja e Qytetit" në Gjakovë është e themeluar në vitin 1981 dhe nga Janari i vitit 2006 është shndërruar në shoqëri aksionare që udhëhiqet nga Bordi i Drejtorëve.

Ndërsa "Ngrohtorja e Re Qytetit" në Gjakovë filloi të ndërtohet në Dhjetor të vitit 2019 dhe është lëshuar në punë në Janar të vitit 2021.

Me miratimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nga Kuvendi i Kosovës në Qershor të 2008, pronare e vetme e kësaj ndërmarrje është Komuna e Gjakovës me 100% të aksioneve.

N.P. 'Ngrohtorja e Qytetit' SH.A. në Gjakovë ka ofruar shërbimet e ngrohjes qendrore duke operuar në sektorin publik, komercial dhe atë të amvisërisë në territorin e qytetit të Gjakovës, ndërsa me lëshim në punë të ngrohtores së re do të vazhdoj të ofroj këto shërbime dhe njëherit të prodhoj edhe energjinë elektrike.

Ndërmarrja do të funksionoj në bazë të ligjeve në fuqi, akteve nënligjore, akteve tjera normative dhe standardeve të kontabilitetit dhe është e regjistruar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) me numrin e regjistrimit të biznesit (NUI) 811326471 më 02 Korrik 2019.

### **Përshkrimi i Kapaciteteve për Prodhimin e Energjisë Termike**

N.P. Ngrohtorja e Re Qytetit SH.A. Gjakovë ka në dispozicion tri njësi prodhuese që shfrytëzojnë lëndën djegëse Biomassën:

- Njësia e kogjenerimit (CHP) me kapacitet 4 MWth dhe 1.1MWel
- Dy kaldaja vetëm për ngrohje (HoB) prej 2x5,5 MWth; dhe
- Rezervuarin i ruajtjes së nxehtësisë 500 m<sup>3</sup> (2 x 250 m<sup>3</sup>).

**Tabela 2: Karakteristikat teknike të njësive**

Njësia prodhuese (përfshirë kogjenerimin)	Viti i lëshimit në punë	Kapaciteti i instaluar termik (MW)	Kapaciteti termik në dispozicion (MW)	Efikasiteti termik (%)	Lloji i lëndës djegëse
Njësia 1 CHP	2021	4 (TH); 1.1 (EL)	3.96 (TH); 1.1 (EL)	70 (TH); 15 (EL)	Biomasë
Njësia 2 HOB	2021	5.5	4.95	85	Biomasë
Njësia 3 HOB	2021	5.5	4.95	85	Biomasë
<b>Total</b>		<b>15 (TH); 1.1 (EL)</b>	<b>13.5 (TH); 1.1 (EL)</b>	<b>80 (TH); 15 (EL)</b>	

Njësitë (CHP, dy HoB dhe Rezervuari i ruajtjes së nxehtësisë) janë të lidhura indirekt me shkëmbyes nxehtësie ujë /ujë, 2 x 9 MW në rrjetin e shpërndarjes.

## Përshkrimi i Rrjetit të Shpërndarjes

Rrjeti i shpërndarjes i N.P. Ngrohësorja e Qytetit' SH.A. në Gjakovë ndahet në dy degëzime kryesore: degëzimi i pjesës veriore të qytetit dhe degëzimi i pjesës jugore (rrjeta e re).

**Tabela 3: Karakteristikat e rrjetit të shpërndarjes**

	Rrjeta veriore e sanuar	Rrjeta jugore
<b>Orientimi</b>	Pjesa veriore	Pjesa jugore
<b>Drejtimi</b>	Nga SH.F. Zekeria Rexha	Nga Spitali i Qytetit
<b>Viti i fillimit të shtrirjes së rrjetit</b>	2022*	2001
<b>Lloji i rrjetit</b>	Gypa të para izoluar	Gypa të para izoluar

\*Rehabilitim i tërësishëm i rrjetit në kuadër të projektit SECO- zëvendësim i tubacioneve të vjetër të çelikut me gypa të para-izoluar

Furnizimi me ngrohje bëhet me sistem indirekt të ngrohjes (këmbyesve të nxehtësisë në nënstacionet termike).


Sistemi i rrjetit është dygypor-indirekt; bazuar në vlerësimet e studimit të fundit të fizibilitetit rrjeti i shpërndarjes është me gjatësi prej rreth 20.5 km trase / 41 km gyp.

Numri i nënstacioneve termike (me këmbyes të nxehtësisë) është 353, ndërsa aktualisht janë aktiv 220 nënstacione termike.

Rrjeti i shpërndarjes në pjesën veriore ka qenë mjaft i vjetër, i instaluar në vitet '80-ta dhe kryesisht me gypa të çelikut (të pa izoluar), ku janë paraqitur edhe defekte dhe rrjedhje të ujit që janë shkaktarë kryesor të humbjeve në rrjet. Tani kjo pjesë e rrjetit është sanuar komplet sipas projektit të lartë cekur me të cilën janë reduktuar plotësisht.

Ndërsa pjesa e jugore e rrjetit është kryesisht me gypa të paraizoluar e instaluar nga donacioni i SIDA-s organizatë Suedeze, dhe qëllimi kryesorë ka qenë të mundësojë kyçjen e Spitalit në rrjetin primar të termofikimit në vitin 2001, por edhe në të cilën vazhdimisht vazhdohet të sanohet dhe mirëmbahet, sipas projektit të SECO-s “Përmirësimi i performancës së Ngrhtores së Qytetit në Gjakovë” – komponenti 3. Avancimi i rrjetit të ngrohjes së Spitalit.

Në vijim paraqitet harta e shtrirjes së rrjetit të shpërndarjes së NQ Gjakova.



**Figura 2: Harta e rrjetit të shpërndarjes**



## Vizioni për zhvillimin e sistemit të energjisë termike

NQ Gjakova, planet afatgjata për prodhimin e energjisë termike i bazon në projektin e tanishëm, që është finalizuar ndërtimi i impiantit të ri dhe fillimi i hyrjes në punë, për Ngrohtoren e Re. Ky projekt do të ketë ndikim në krijimin e një burimi të sigurt, ekonomikisht të favorshëm dhe të përshtatshëm në kuptim të mbrojtjes së ambientit.

Si aktivitete pasuese të projektit për ngrohtoren e re, në vitet e ardhshme priten investime të konsiderueshme në rehabilitimin e rrjetit të ngrohjes, për rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjetit, që do të rezultojnë në zgjerimin e bazës së konsumatorëve përkatësisht rritjen e sipërfaqes ngrohëse të kyçur në sistemin e ngrohjes qendrore të NQ Gjakova.

Parashikimi i kërkesës për ngrohje për një periudhë të gjatë përfshin disa faktorë si:

- Planet për zgjerimin e bazës së konsumatorëve e rrjedhimisht edhe të sipërfaqes ngrohëse të konsumatorëve, që është ngushtë e lidhur me zgjerimin e rrjetit dhe kapacitetet prodhuese;
- Konsumin specifik të ngrohjes që është ngushtë i lidhur me masat e efijencës së energjisë në anën e kërkesës (konsumatorëve) dhe me sjelljen e konsumatorëve në kuptim të kursimit të energjisë, si dhe masave të tjera të efijencës së energjisë të zbatuara nga ndërmarrja e NQ për të nxitur shfrytëzimin eficient dhe kursimin e ngrohjes (p.sh. matja e ngrohjes dhe faturimi bazuar në konsumin e matur);
- Përgjithësisht tregun i ngrohjes dhe konkurrencën me lëndët tjera djegëse dhe burimet tjera të ngrohjes, në kuptim të çmimit, besueshmërisë dhe komfortit, të cilat ndikojnë në gatishmërinë e konsumatorëve për:
  - i) të vazhduar me shfrytëzimin e ngrohjes qendrore (konsumatorët ekzistues) ose
  - ii) të kalojnë në shërbimin e ngrohjes qendrore (konsumatorët e rij).

Sipërfaqja ngrohëse konsiderohet ndër parametrat më të rëndësishëm për të përcaktuar konsumin në të ardhmen. Sipërfaqet ngrohëse të parashikuara, siç janë treguar në tabelën më poshtë, është projektuar të rriten dukshëm duke marrë parasysh dy faktorë kryesorë:

- Riaktivizimin gradual të konsumatorëve pasiv, ashtu që rrisin sipërfaqen ngrohëse 'aktive' nga 81,313 m<sup>2</sup> në 2022 në 181,726 m<sup>2</sup> në 2024, që është afërsisht sipërfaqja aktuale e kyçur fizikisht në rrjetin e ngrohjes.
- Kyçjet e reja brenda zonës ekzistuese të shërbimit për të rritur 'dendësinë e ngrohjes' në rrjet, dhe
- Zgjerimi i rrjetit në zonat e reja të shërbimit, që janë ngushtë të lidhura me masat dhe projektet zhvillimore, të specifikuara në kapitujt vijues.

Megjithatë në vitin 2022 janë ndërmarr disa riparime emergjente në rrjetin e shpërndarjes me qëllim të zvogëlimeve të humbjeve në rrjet. Po ashtu planifikohet një rritje e sipërfaqes ngrohëse prej rreth 51,206 m<sup>2</sup>. Detajet janë të paraqitura sikurse në vijim:

**Tabela 4: Zgjerimi i planifikuar i sipërfaqes ngrohëse në vitin 2022**

Viti	Sip. Ngroh. aktuale [m <sup>2</sup> ]	Zgjerimi i Sip. Ngroh. [m <sup>2</sup> ]	Sip. Ngroh. Totale e kyqur [m <sup>2</sup> ]
2022	81,311	-	
2023	81,311	51,206	132,517

## PARASHIKIMI I KËRKESËS PËR ENERGJI TERMIKE

### Metodologjia

Metodologjia e përdorur për parashikimin e kërkesës për ngrohje është bazuar në të dhënat historike të konsumit të ngrohjes, karakteristikat e sistemit të ngrohjes qendrore në kuptim të mundësisë për zgjerimin e rrjetit e rrjedhimisht të bazës së konsumatorëve, si dhe të kapaciteteve prodhuese të energjisë termike. Gjithashtu në parashikimin e kërkesës janë marrë për bazë projeksionet zhvillimore të Ngrohtorja e Qytetit, Gjakovë.

Projeksionet zhvillimore të sistemit të ngrohjes qendrore të NQ Gjakova për prodhimin të energjisë termike kryesisht i bazon në projektin e tanishëm të ngrohtores së re, që përfshinë njësinë e ko - gjenerimit me lëndën djegëse biomasë. Po ashtu projeksionet zhvillimore përfshijnë planifikimet për rehabilitim të rrjetit ekzistues dhe për zgjerim të rrjetit të shpërndarjes. Kjo do të ndikoj në rikthimin e konsumatorëve (aktualisht "pasiv") dhe në rritjen e bazës së konsumatorëve, e rrjedhimisht ndikon në rritjen e sipërfaqes ngrohëse, që janë faktorë përcaktues për rritjen e konsumit të ngrohjes.

### Detaje për parashikimin vjetor të kërkesës

Për parashikimin e kërkesës / konsumit, një komponent e rëndësishme është shfrytëzimi i të dhënave për konsumin në sezonin e kaluar. Kështu për vitin 2023 planifikojmë rreth 7289 ton biomasë. Pra gjatë vitit 2023 do të vazhdohet të operohet me Impiantin e Ri me lëndë djegëse biomasë që planifikojmë të operojmë deri në fund të sezonës, përkatësisht deri në Prill, 2023.

Në tabelën vijuese është paraqitur planifikimi vjetor i kërkesës dhe furnizimit me energji termike.

**Tabela 5: Parashikimi i furnizimit / kërkesës për energji termike**

KËRKESA E KONSUMATORËVE PËR ENERGJI TERMIKE – VITI 2023									
	Konsumatorët Shtëpiak			Konsumatorët Komercial e Institucional			Total Konsumatorët		
	Sip. Ngroh. (m <sup>2</sup> )	Kapac. Term. (MW)	Sasia e en. term. (MWh)	Sip. Ngroh. (m <sup>2</sup> )	Kapac. Term. (MW)	Sasia e en. term. (MWh)	Sip. Ngroh. (m <sup>2</sup> )	Kapac. Term. (MW)	Sasia e en. term. (MWh)
Janar	40,157	3.61	1,323	72,993	7.30	1,859	113,150	10.91	3,182
Shkurt	40,157	3.61	1,109	72,993	7.30	1,549	113,150	10.91	2,658
Mars	40,157	3.61	1,027	72,933	7.29	1,509	113,090	10.91	2,536
Prill	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Tetor	65,798	5.92	380	84,830	8.48	531	150,628	14.40	911
Nëntor	66,225	5.96	1,208	85,272	8.53	1,688	151,497	14.49	2,896
Dhjetor	67,798	6.10	1,549	85,790	8.58	2,165	153,588	14.68	3,714
Total / Mes. *	53,382	4.80	6,596	79,135	7.91	9,300	132,517	12.72	15,896

Në tabelën më poshtë paraqitet kërkesa e planifikuar për energji termike përfshirë edhe humbjet në rrjet.

**Tabela 6: Parashikimi i kërkesës për energji termike plus humbjet në rrjet për vitin 2023**

KËRKESA PËR ENERGJI TERMIKE (KËRKESA E KONSUMATORËVE PLUS HUMBJET NË RRJET) – VITI 2023								
Përshkrimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
Kërkesa e konsumatorëve për energji termike (MWh)	3,182	2,658	2,536	-	911	2,896	3,714	15,896
Total humbjet sasiore në rrjetin e shpërndar. (MWh)	629	546	447	-	231	593	809	3,255
Total kërkesa e kons. plus humbjet (MWh)	3,811	3,204	2,983	-	1,142	3,489	4,523	19,151

## Parashikimi i humbjeve në Rrjet

Në sezonin 2022/2023 humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes janë vlerësuar rreth 17% që paraqet përsëri një nivel të lartë të humbjeve edhe për kundër disa sajimeve / lokalizimin rrjedhave të mëdha në rrjetin e termofikimit, mirëpo janë paraqitur rrjedhje të tjera në pjesën jugore edhe pse projekti i SECO-s Zvicerane, konkretisht ndërimi i gypave të vjetër të në pjesën e veriut ka përfunduar me suksese.

Në vitin/sezonin vijues janë parapare disa riparime dhe rehabilitime emergjente me ndikim në zvogëlimin e nivelit të humbjeve në rrjetin primar të termofikimit por edhe sekondar të pjesës jugore.

**Tabela 7: Parashikimi i humbjeve në rrjetin e shpërndarjes – viti 2023**

HUMBJET NË RRJET - VITI 2023								
Përshkrimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total/ Mesatare
Humbjet sasiore në rrjetin e transportimit (nëse është e aplikueshme) (MWh)	-	-	-	-	-	-	-	-
Humbjet në përqindje në rrjetin e transportimit (%)	-	-	-	-	-	-	-	-
Humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes (MWh)	629	546	447	-	231	593	809	3,256
Humbjet në përqindje në rrjetin e shpërndarjes (%)	17%	17%	17%	-	17%	17%	17%	17%
Total humbjet sasiore në rrjet (MWh)	629	546	447	-	231	593	809	3,256
Total humbjet në rrjet në përqindje (%)	17%	17%	17%	-	17%	17%	17%	17%

## Parashikimi i prodhimit të energjisë termike

Duke qenë se edhe në vitin 2023 do të vazhdohet operimi me impiantin e ri me lëndë djegëse biomasë-ashkla të drurit, çmimi i së cilës është rritur për shkak inflacionit ndërkombëtar, do të mbulohet komplet sasia e konsiderueshme me subvencionet nga Buxheti i Kosovës dhe mjete vetanake. Për këtë arsye për parashikimin e prodhimit të energjisë termike jemi bazuar rrjedhimisht në prodhim të plotë deri në fund të vitit / sezonës. Planifikimet për prodhimin e energjisë termike përgjithësisht janë vlerësuar për të mbuluar kërkesën e parashikuar për energji termike (konsumin).

Në tabelën më poshtë janë paraqitur prodhimi bruto dhe neto i energjisë termike, sipas muajve për vitin 2023.

**Tabela 8: Parashikimi i prodhimit bruto dhe neto të energjisë termike**

PRODHIMI I ENERGISË TERMIKE								
Përshkrimi/Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total/Mesatare
Energjia nga lënda djegëse (MWh)	4,371	3,791	3,100	-	1,603	4,115	5,617	22,597
Efikasiteti termik i stabilimenteve prodhuese në Ngrohtore (%)	85%	85%	85%	-	85%	85%	85%	85%
Bruto prodhimi në stabilimentet prodhuese të energjisë termike (HoB) (MWh)	3,715	2,565	2,250	-	1,035	2,773	3,824	16,162
Bruto prodhimi në stabilimentet e kogjenerimit (nëse është e aplikueshme) (MWh)	0	657	385	-	328	725	950	3,045
Total bruto prodhimi i energjisë termike (MWh)	3,715	3,222	2,635	-	1,363	3,498	4,774	19,207
Humbjet sasiore në rrjetin e transportimit (nëse është e aplikueshme) (MWh)	-	-	-	-	-	-	-	-
Konsumi vetanak (MWh)	15	8	5	-	5	8	15	56
<b>Neto prodhimi i energjisë termike (MWh)</b>	<b>3,700</b>	<b>3,214</b>	<b>2,630</b>	<b>-</b>	<b>1,358</b>	<b>3,490</b>	<b>4,759</b>	<b>19,151</b>

## Planifikimi i remonteve dhe riparimeve

Pasi që është viti i dytë i instalimit të këtyre njësive të reja nuk është parashikuar ndonjë riparim apo remont i planifikuar. Impianti është dorëzuar në Korrik 2021. Në vitet në vazhdim do të parashikohen dhe zbatohen gjitha udhëzimet për mirëmbajtje dhe remonte periodike sipas udhëzimeve nga prodhuesi.

**Tabela 9: Planifikimet e riparimeve, remonteve dhe mirëmbajtjeve në vitin 2023**

PLANIFIKIMET E RIPARIMEVE, REMONTEVE DHE MIRËMBAJTJEVE NË VITIN 2023													
Muajt	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total muajt
Njësia e prodhimit të En. Term.													
Gjeneratori U1													
Gjeneratori Un													
Total R, r													

*'R' i referohet Remonteve, Riparimeve Madhore; 'r' i referohet remonteve dhe riparimeve të zakonshme*

## PËRMBLEDHJE E BILANCIT VJETORË ENERGJISË TERMIKE PËR VITIN 2023

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Vlera
1	Energjia nga lënda djegëse - biomasa	(MWh <sub>TH</sub> )	22,597
2	Efikasiteti termik i stabilimenteve prodhuese në Ndrohtore	(%)	85%
3	Prodhimi bruto i energjisë termike në Stabilimentet prodhuese të energjisë termike (HoB)	(MWh <sub>TH</sub> )	16,162
4	Prodhimi bruto i energjisë termike në stabilimentet e kogjenerimit	(MWh <sub>TH</sub> )	3,045
5	Total Bruto Prodhimi i energjisë termike	(MWh <sub>TH</sub> )	19,207
6	Humbjet sasiore në rrjetin e transportit (rrjetin e kogjenerimit)	(MWh <sub>TH</sub> )	-
7	Humbjet në përqindje në rrjetin e transportit	(%)	-
8	Konsumi vetanak	(MWh <sub>TH</sub> )	56
9	Neto Prodhimi i energjisë termike / energjia termike e futur në rrjetin e shpërndarjes	(MWh <sub>TH</sub> )	19,151
10	Humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes	(MWh <sub>TH</sub> )	3,256
11	Humbjet në përqindje në rrjetin e shpërndarjes	(%)	17.00%
12	Furnizimi me energji termike	(MWh <sub>TH</sub> )	15,896
13	Shpenzimi i lëndës djegëse	(ton)	7,289
14	Sipërfaqja ngohëse	m <sup>2</sup>	132,517
15	Numri i nënstacioneve termike		353
16	Kapaciteti i instaluar prodhues	MW	15 (TH); 1.1 (EL)
17	Gjatësia e tubacionit të rrjetit	km	41